



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 11, 14.2 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, nenit 7 paragrafi 3 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 4 të Rregullores QRK 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenet 14 dhe 17.1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2017, miratoi,

VENDIM

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, PALUJTSHMËRINË DHE OBJEKTIN HOTELIER NË FSHATIN ORLLAN

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të paluajtshmërive në pronësi të Komunës, dhe atë:

-Pjesa e paluajtshmërisë të evidentuar në ngastrën kadastrale P-71712058-01339-0 në sipërfaqe 1500 m² me kulturë tokë ndërtimore, së bashku me objektin hotelier në sipërfaqe prej 259 m², vendi i quajtur Orllan, certifikata pronësore nr.08/942/0321234/17 e datës 17.03.2017, Zona kadastrale Orllan.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të paluajtshmërisë dhe objektit në pronësi të Komunës, është ushtrimi i veprimtarisë hoteliere.

Neni 3

Pjesa e paluajtshmërisë dhe objekti jepen në shfrytëzim afatshkurtër për periudhën 15 vjeçare.

Neni 4

Procedura e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmesë konkurrencës së hapur publike përkatësisht ankandit publik, konform Rregullores (QRK) 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Komisioni i ngritur nga Kuvendi, pas zbatimit të procedurave të konkurrencës së hapur publike, Kryetarit të Komunës i dërgon ofertën e përzgjedhur për lidhjen e kontratës me të cilën rregullohen të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës.

Neni 6

Zbatimin e Vendimit e bën Komisioni vlerësues për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-060/04-26127/17

Podujevë,

31 mars 2017





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo


Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : **PODUJEVË**
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: **Orllan**

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-71712058-01339-0	Pracelë / Parcela / Parcel	2106,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 21.03.2017

Koha/ Vreme/ Time: 10:18:28

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

01/03/2017/17
Aprovuar/Isvojio/Approved: MCO PODUJEVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

